



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 137 dt. 24.12.2014

Në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 24.12.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Shtyhet vendimarrja për projektin e HEC- Lengarica mbi lumin Lengarica, Komuna Petran, Gjirokastrë, për mbledhjen pasardhëse të KKR.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike, të përpilojë një relacion të plotë për gjithë procedurën e ndjekur për shqyrtimin e këtij projekti, që nga fillimi i aplikimit të shoqërisë deri më dt. 24.12.2014.
3. Dosja me relacionin e plotë dhe dokumentacionin përkatës do t'u shpërndahet anëtarëve të KKR-së përpara zhvillimit të mbledhjes pasardhëse.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO PURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI